



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

---

Numri i lëndës: 2023:187410  
Datë: 26.03.2024  
Numri i dokumentit: 05506568

PPP.nr.25/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për Çështje Civile, me gjyqtaren Lirika Sylaj, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike sh.a (KES-co) me seli në Prishtinë, kundër debitorit N.H nga fshati D., Komuna e I., lidhur me çështjen përmbartimore në bazë të dokumentit të besueshëm - ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve të energjisë elektrike, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit, jashtë seancës gjyqësore, me datë 26.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET si i paafatshëm prapësimi i debitorit N.H i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.193/23 të datës 10.07.2023, i lëshuar nga Zyra Përmbartimore me përmbartuesin privat - Fatos Shatri në Pejë, ndërsa, Urdhri Përmbartimor P.nr.193/23 i datës 10.07.2023, MBETET në fuqi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KES-CO), ka caktuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.193/23 të datës 10.07.2023, duke e lejuar kështu në bazë të dokumentit të besueshëm - ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve energjisë elektrike, që brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, debitori t'ia paguajë kreditorit shumën prej 516.04 Euro në emër të borxhit kryesor me kamatë 8 % nga dita e kalimit të afatit për pagesë e deri në pagesën definitive.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit, debitori ka ushtruar prapësim duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta anuloj urdhrin për përmbartim.

Kreditori brenda afatit ka ushtruar përgjigje në prapësimin e debitorit, me të cilën gjykatës i ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, udhrit përmbarimor, prapsimit të paraqitur nga debitori si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për afatshmërinë e prapësimit konstatoi se prapësimi në fjalë është paraqitur jashtë afatit ligjor të paraparë në nenin 70, të LPP-së, në të cilin përcaktohet se *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues”*. Nga shkresat e lëndës, gjegjësisht sipas fletë kthesës për dorëzim personal mbi dorëzimin e urdhrin për përmbarim, vërtetohet se debitori urdhrin për përmbarim e ka pranuar me datën 14.07.2023, ndërsa, prapësimin e ka paraqitur në zyrën e përmbaruesit privat me datën 25.08.2023, që nënkuptohet se nga pranimi i urdhrin përmbarimor e deri më ditën e paraqitjes së prapësimit kanë kaluar 42 ditë.

Andaj, gjykata bazuar në nenin 70 dhe 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA NË ISTOG  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për Çështje Civile  
PPP.nr.25/23, datë 26.03.2024

Gj y q t a r j a  
Lirika Sylaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.